Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Oda e Psikologëve të R. së Maqedonisë

NDËRPRERJA E CIKLIT TË DHUNËS

PARANDALIMI SISTEMIK I DHUNËS NË FAMILJE



Република Северна Македонија
Министерство за образование и наука

КОМОРА НА ПСИХОЛОЗИ
на Република Македонија

Mësojmë. Parandalojmë. Ndryshojmë

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Parandalimi fillon me **njohjen**.
Siguria fillon me **dëgjimin**.
Ndërsa ndryshimi fillon kur shkolla bëhet vendi ku fëmiu e din se **nuk është vetëm**.

PROGRAMI I TRAJNIMIT

Struktura e trajnimit

1

PJESA E PARË

- Dhuna në familje
- Indikatorët
- Vlerësimi i rrezikut

2

PJESA E DYTË

- Trauma te fëmijët
- NPP dhe kufijtë
- Intervistë me fëmiun

3

PJESA E TRETË

- Zgjidhje institucionale
- Evaluim

PËR TRAJNUESIT

Rekomandime për trajnuesit

FILLIMI

- Përshëndetje dhe prezentim i shkurtër
- Sqarim se tema është e ndjeshme dhe mund të çele reagime personale
- Nxitje e atmosferës së sigurt dhe respektuese

GJATË ECURISË SË TRAJNIMIT

- Shmang mbingarkimin me teori
- Shpesh kyç diskutim
- Shfrytëzp shembuj praktik
- Kujdes ndaj reagimeve emocionale të pjesëmarrësve
- Nxit ndjesinë e kompetencës , jo të frikës

THEKSO: Qëllimi nuk është „hetimi“, por siguria dhe mbështetja.

PËR TRAJNUESIT

Rregullat e komunikimit

- Besueshmëri
- Respekt
- E drejta për pauzë
- Pjesëmarrje aktive
- Pa gjykim

PYETJE PËR PJESËMARRËSIT

Cila është sfida më e madhe kur bëhet fjalë për detektimin e dhunës në familje?

DETEKTIMI

Mitet dhe faktet

MIT

„Nëse fëmiu nuk tregon asgjë – nuk ka problem.“

FAKT

„Fëmijët më shpesh shprehen përmes sjelljes.“

MIT

„Vetëm dhuna fizike është e rezikshme.“

FAKT

„Dhuna psikologjike ka pasoja afatgjate.“

AKTIVITET: Diskutim i shkurtë me grupën.

01

PJESA E PARË

Dhuna në familje

Dhuna në familje është çdo sjellje në mjedisin familjar ose në partneritet që shkakton dëm **fizik, psikologjik, seksual** ose **ekonomik.**



Format e dhunës në familje

Dhuna fizike

- GODITJE
- SHUPLAKË
- SHTYERJE
- KËRCËNIM ME ARMË
- KUFIZIM I LËVIZJES

Dhuna psikologjike

- FYERJE
- NËNÇMIM
- KËRCËNIM
- IZOLIM
- KONTROLLË

Dhuna seksuale

- KONTAKTE TË PADËSHIRUARA SEKSUALE
- DETYRIM
- SHFRYTËZIM

Dhuna ekonomike

- KONTROLLIM I FINACAVE
- MARJA E MJETEVE
- NDALESË PËR PUNËSIM

PJESA E PARË – DHUNA NË FAMILJE

Ndikimi mbi fëmijën

Fëmijët mund të jenë:

Viktima direkte

Viktima indirekte (dëshmitar të dhunës)

Pasojat te fëmijët:

Fizike	Kokëdhimbje, dhimbje në stomak, gjendje të lidhura me stres kronik.
Emocionale	Ankth, depresion, faj, turp, vetëbesim i ulët.
Kognitive	Zvogëlim i koncentrimit dhe vëmendjes, vështirësi në mësim.
Biheviorale	Agresivitet, tërheqje, ikje nga orët , vetëlëndim.
Sociale	Izolim, mosbesim, konflikt me bashkëmoshatarët.

PJESA E PARË – DHUNA NË FAMILJE

Efektet afatshkurtra të dhunës në familje mbi fëmijët?

Fëmijët që jetojnë në shtëpi ku njëri prind është viktimë e dhunës shpesh ndihen të frikësuar dhe me ankth. Ata mund të jenë vazhdimisht në gjendje gatishmërie, duke pritur kur do të ndodhë ngjarja e radhës e dhunshme. Kjo mund të shkaktojë reagime të ndryshme, në varësi të moshës së fëmijës.

MOSHA PARASHKOLLORE

- Urinim në shtrat
- Thithja e gishtit të dorës
- Të qara të shpeshta dhe jargëzim
- Vështirësi për të fjetur ose për gjum
- Shenja të frikës si belbëzim ose fshehje
- Ankth intensiv prej largimit të prindit

MOSHA SHKOLLORE

- Ndjenja e fajit dhe vetëfajësimit
- Ndikim negativ mbi vetëbesimin e tyre
- Kyçje minimale në aktivitetet shkollore.
- Sukses më i dobët, më pak shokë
- Përfshirje më e shpeshtë në probleme
- Kokëdhimbje të shpeshta dhe dhimbje në stomak

TINEJXHER

- SJELLJE NEGATIVE:
  Ikje nga shkolla, përleshje me familjen
- SJELLJE TË RREZIKSHME: Marrëdhënie të pambrojtura seksuale , përdorim i alkoholit dhe drogës
- Vetëbesim i ulët dhe vështirësi në krijimin e miqëve
- Fillojnë me rrahje, malltretojnë tjerët dhe probleme më të shpeshta me ligjin.

* Ky lloj veprimi më i shpeshtë është te djemtë të cilët kanë qenë të përfshirë në dhunë gjatë fëmijërisëndërsa te vajzat më shpesh paraqitet tërheqja dhe depresioni.

CIKLI I DH

Efektet afatëgjata prej dhunës në familje mbi fëmijët?

Fëmijët që jetojnë në shtëpi ku së paku njëherë ka ndodhur dhunë në familje kanë rrezik më të lartë si të rritur që të përsërisin siklin e dhunës-ose si viktima në lidhje të dhunshme ,ose si dhunues.

10×

Më shumë gjasa djali që ka parë abuzim të nënës së tij,të keqtrajtojë partneren e tij si i rritur.

6×

Rreziku më i madh vajza që është rritur në familje ku babai e ka abuzuar nënën, të jetë e abuzuar seksualisht

Fëmijët që kanë qenë dëshmitarë ose viktima të abuzimit emocional, fizik ose seksual kanë një rrezik më të lartë për të zhvilluar probleme shëndetësore në moshën e rritur. Këtu përfshihen çrregullime të shëndetit mendor, si ankthi, por edhe gjendje fizike si diabeti, obeziteti, sëmundjet e zemrës, vetëvlerësimi i ulët dhe pasoja të tjera serioze.

PËRMASA GLOBALE

275 MILION

Fëmijë të prekur

725 MILION

Të rritur të prekur



https://player.vimeo.com/video/981445334

Dhuna në familje është një nga përvojat më pak të njohura negative në fëmijëri (ACE). Rritja e ndërgjegjësimit është thelbësore — vetë njohja e këtij fenomeni ofron validim, e lehtëson bisedën për këtë temë dhe përbën hapin e parë drejt tejkalimit dhe zvogëlimit të pasojave.

NJOHJA · INDIKATORËT

Shenjat emocionale dhe fizike

Indikatorët emocional

- Frikë , ankth, tërheqje
- Vetëbesim i ulët
- Dëgjueshmëri e tepëruar
- Ndryshime të papritura në disponim

Indikatorët fizik

- Mavijosje, gërvishtje, djegie
- Lëndime të shpeshta „të pashpjegueshme"
- Higjienë dhe pamje e lënë pas dore
- Lodhje e shpeshtë ose përgjumje

NJOHJE · INDIKATORË

Shenja bihevioralе dhe shkollore

Bihevioral

- Agresivitet dhe nervozizëm
- Izolim nga të rriturit
- Probleme në koncentrim
- Sjellje regresive

Shkollore

- Mungesa të shpeshta
- Rrënie e suksesit
- Vështirësi në sjellje
- Frikë nga kthimi në shtëpi

E rëndësishme: një indikatorë i vetëm nuk do të thotë domosdoshmërisht dhunë — por prania e mës humë shenjave kërkon vëmendje dhe vlerësim.

PJESA E AGRESIVITETI T

Agresiviteti mund të jetë...

- **Fizik**
- **Verbal**
- **Relacional**
- **Pasiv-agresiv**
- **Agresion online**

> *Agresioni është një **sinjal**, jo vetëm sjellje problematike.*

PJESA E PARË · AGRESIVITETI

Shenja të pritshme zhvillimore

Sjellja agresive mund të jetë pjesë **zhvillimit normal** — veçanërisht kur fëmija ende po mëson të shprehë emocionet, nevojat dhe frustrimet.

Është e rëndësishme të vlerësohet nëse sjellja është e **përshtatshme për moshën**, sa shpesh shfaqet dhe nëse e dëmton fëmijën ose mjedisin përreth.

PJESA E PARË · AGRESIVITETI TE FËMIJËT

Mosha e hershme shkollore

6–10 vjeç · Agresiviteti zakonisht bëhet më i kontrolluar.

Është e mundur

- Grindje me bashkëmoshatarët,kokëfortësi
- Fyerje verbale
- Sjellje pasive-agresive
- Reagime ndaj padrejtësisë ose talljes

Fëmiu duhet tashmë

- Të kuptoj pasojat
- Të mund të qetësohet përmes ndihmës

PJESA E PARË ·AGRESIVITETI TE FËMIJËT

Adoleshenca

NË PUBERTET

- Rritje e irritimit
- Reagime emocionale të forta
- Konflikte verbale
- Rezistencë ndaj autoritetit

SHKAQET

- Ndryshime hormonale
- Zhvillimi i identitetit
- Nevojë për autonomi
- Presioni i bashkëmoshatarëve

SHENJA ALARMANTE

- ! Mizori , dhunë e planifikuar
- ! Armë
- ! Vetëlëndim
- ! Shpërthime intesive

PJESA E PARË · AGRESIVITETI TE FËMIJËT

Kur agresiviteti nuk është i pritshëm në bazë të zhvillimit?

Nevoitet vlerësim shtesë nëse:

- ! Agresiviteti është shumë i shpeshtë dhe intensiv
- ! Fëmiu seriozisht lëndon të tjerët
- ! Nuk ka ndjenjë faji apo empatije
- ! Sjellja zgjat për një periudhë të gjatë
- ! Ka shkatërim të objekteve ose kërcënim
- ! Ndryshim të menjëhershëm në sjellje
- ! Agresiviteti shfaqet në më shumë mjedise — në shtëpi ,shkollë, me bashkëmoshatarët

Faktorët që ndikojnë në agresivitet

- Konflikte familjare
- Ekspozim ndaj dhunës
- Stres ose traumë
- Aftësi komunikimi të zhvilluara pamjaftueshëm
- Vështirësi me rregullimin emocional
- Vështirësi zhvillimore ose psikologjike

PJESA E AGRESIVITETI TE

Shkalqet e agresivitetit

Faktorët PSIKOLOGJIK

Faktorët FAMILJAR

Faktorët SHKOLLOR

Faktorët SOCIALË

Faktorët PSIKOLOGJIK

PJESA E PARË · AGRESIVITETI TE FËMIJËT

Shkaqet e agresivitetit

Faktorë biologjikë

Temperamenti, veçoritë neurologjike dhe ndryshimet hormonale mund të ndikojnë në shfaqjen e sjelljes agresive.

Faktorë familjarë

Konfliktet në familje, edukimi jo i qëndrueshëm dhe ekspozimi ndaj dhunës e rrisin rrezikun për agresivitet.

Faktorë shkollorë

Problemet me bashkëmoshatarët, presioni shkollor dhe mungesa e mbështetjes mund të shkaktojnë reagime agresive.

Socialë dhe psikologjikë

Vetëbesimi i ulët, toleranca e zvogëluar ndaj frustrimit, stresi, frustrimi dhe vështirësitë në rregullimin emocional kontribuojnë në sjellje agresive.

Agresivitet reaktiv dhe proaktiv

Reaktiv

- Reagim impulsiv ndaj kërcënimit
- Shpërthim emocional

Proaktiv

- I kontrolluar dhe i orientuar drejt fuqisë
- Manipulativ

AKTIVITET: Pyetësor për agresivitet reaktiv dhe proaktiv.

PJESA E PARË · INSTRUMENT

Vlerësimi i rrezikut te fëmijët-viktima të dhunës në familje

Rreziku është **probabiliteti** që fëmija të ekspozohet përsëri ndaj dhunës ose të pësojë pasoja serioze.

VLERËSIMI I RREZIKUT

Faktorët e rrezikut

TË LIDHUR ME DHUNUESIN

- Përdorim i drogave
- Çrregullim psikik
- Posedim i armës
- Dhunë e mëparshme
- Keqpërdorim i alkoolit

TË LIDHUR ME FAMILJEN

- Izolim social
- Varfëri
- Konflikte kronike
- Moskujdes dhe neglizhencë
- Shkurorëzim

TË LIDHUR ME FËMIJËN

- Aftësi e kufizuar
- Izolim
- Viktimizim i mëparshëm
- Moshë e vogël

VLERËSIMI I RREZIKUT

Nivelet e rrezikut

Rrezik i ulët — Konflikt i njëhershëm pa pasoja serioze

- Megjithatë, nevojitet ndjekje

Rrezik i mesëm

- Dhunë psikologjike e përsëritur
- Frikësim
- Kontrollim
- Abuzim emocional

Rrezik i lartë
Nevojitet reagim i menjëhershëm

- Dhunë e rëndë fizike
- Kërcënime për jetë
- Dhunë seksuale
- Ide vetëvrasëse
- Përdorim i armës
- Fëmijë i mitur i lënë pa kujdes

INSTRUMENT

Matrica e rrezikut

Instrument i strukturuar për renditjen e probabilitetit dhe peshës së rrezikut në rast konkret.

docs.google.com → Matrica e rrezikut



MATRICA E RREZIKUT

UDHËZIM:

Çdoindikatorvlerësohet: 0 = nuk ka, 1 =të lehtë, 2 = mesatarisht, 3 =tëshprehur

Pikëtmblidhensipaskategorivedhenëtotal.

A. INDIKATORET EMOCIONAL

Indikator	0	1	2	3
ankth				
frikë				
tërheqje				
paqëndrueshmëri emocionale				

Nën-grupi A: __/12

B. BIHEJVIORAL

Indikator	0	1	2	3
agresivitet				
izolim				
regres				
sjellje e rrezikshme				

Nën-grupiB: __/12

C. KOGNITIV

Indikator	0	1	2	3
rënie e suksesit				
koncetrim				
dezorientim				
"shkëputje"				

Nën-grupiC: __/12

D. FIZIK

Indikator	0	1	2	3
dhimbje somatike				
lodhje				
lëndime				
pamje e lënë pas dore				

Nën-grupiD: __/12

E. INDIKATORËT KRITIKË (me pikë peshuese)

Indikator	Pikët
frikë nga shtëpia	+5
deklaratë për dhunë	+7
lëndime të dukshme	+7
neglizhencë	+5

Nën-grupiE: __/24

PIKET E PERGJITHSHME

A+B+C +D+E = _____/72

INTERPRETIMI

Pikët	Niveli	Masa
0–15	**i ulët**	**monitorim**
16–30	**mesatar**	**vlerësim me ekip**
31–50	**i larët**	**ndërhyrje intensive**
51+	**kritik**	**njoftim urgjent**

RREGULLA PROFESIONALE:
nëseekzistonnjëindikatorkritik, niveli minimal automatikisht = rrezikilartë

INSTRUMENT

Formular për vlerësimin e dhunës në familje

Formular i standardizuar për shënimin e indikatorëve dhe nivelit të rrezikut në rast konkret.

docs.google.com → Formular për vlerësim



Formular për vlerësimin e dhunës në familje (në kontekst shkollor)

Ky formular shërben për vlerësimin e rrezikut fillestar në shkollë dhe nevojës për mbrojtje/referim. Nuk është vlerësim forenzik dhe nuk është instrument diagnostikues.

Identifikimi

Shkolla _____

Psikologu _____

Klasa/mosha _____

1. Arsyeja e vlerësimit

Përshkrim i shkurtër i ngjarjes/shqetësimit: _____

_____

_____

_____

2. Indikatorët (shënoni ✓)

Fizik	Psikologjik/emocional	Shkollor/social
☐ Mavijosje (shenja)/lëndime me shpjegim të paqartë	☐ Frikë e theksuar/ankth	☐ Ndryshime të papritura të suksesit
☐ Lëndime të shpeshta	☐ Tërheqje/depresion	☐ Mungesa të shpeshta
☐ Veshje e papërshtatshme për lëndime	☐ Zemërim/agresivitet	☐ Izolim nga bashkëmoshatarët
☐ Higjienë/kujdes i neglizhuar	☐ Hipervigjilencë (gjendje e vazhdueshme “alarmi”)	☐ Probleme në sjellje
	☐ Probleme me gjumin/makthe	☐ Frikë nga kthimi në shtëpi
	☐ Vetëfajësim/turp	

3. Vlerësimi i rrezikut (0–3)

Fusha	0	1	2	3
Rrezik aktual fizik				
Rrezik për përsëritje të dhunës				
Ndjeshmëri psikologjike				
Vetëlëndim/rrezik suicidal				
Mungesë e një të rrituri mbrojtës				

0 = nuk ka indikacione, 1 = të lehta, 2 = të rëndësishme, 3 = indikacione urgjente/serioze

Rreziku total: ____ / 15

Interpretimi	Masat
0–4 I ulët	Monitorim, mbështetje, rivlerësim
5–9 Mesatar	Aktivizim i ekipit të shkollës, plan sigurie, konsultim me Qendrën për Punë Sociale (QPS)
10–15 I lartë	Sigurim urgjent i sigurisë, njoftim i drejtorit/QPS-së, ndërsa kur ka rrezik të menjëhershëm – policia/ndihma e shpejtë.

Indikatorët kritikë

1. Lëndime të rënda/të freskëta ose nevojë për ndihmë mjekësore.
2. Frikë e shprehur nga kthimi në shtëpi.
3. Kërcënime me armë, mbytje, kërcënime serioze për jetën.
4. Dhunë seksuale/shfrytëzim seksual.
5. Synime/plan për vetëvrasje ose vetëlëndim serioz.
6. Nuk ka asnjë të rritur të sigurt që mund ta marrë fëmijën nën përkujdesje.

4. Plani për siguri (versioni i shkurtër)

- Vendi i sigurt në shkollë: _____
- Personi për kontakt në shkollë: _____
- I rritur/i afërm i sigurt (nëse është e zbatueshme): _____
- Çfarë do të bëjë nxënësi nëse ndjehet i rrezikuar: _____
- Institucionet/kontaktet: QPS, policia, ndihma e shpejtë, shërbimet lokale.

Dokumentimi dhe njoftimi

- Drejtori i njoftuar: Po Jo (koha: _____)
- QPS e kontaktuar: Po Jo (koha: _____)
- Policia e kontaktuar: Po Jo (koha: _____)
- Prindi/kujdestari i kontaktuar: Po Jo (koha: _____)
- Arsyja nëse NUK është kontaktuar prindi/kujdestari: _____

5. Plani i ndjekjes

Mbështetje psikologjike _____

Kontakt me mësimdhënësit _____

Rivlerësim _____

Nënshkrimi: _____

Parimet për dokumentim

1. Shënoni fakte dhe deklarata të drejtpërdrejta, jo përfundime. Përdorni thonjëza për fjalitë kyçe të fëmijës.
2. Shënoni datën, kohën dhe personat e pranishëm.
3. Ruani dokumentacionin sipas rregullave për konfidencialitet dhe mbrojtje të të dhënave personale.

02

PJESA E DYTË

Trauma te fëmijët dhe adoleshentët

në kontekst të dhunës në familje



PJESA E DYTË · TRAUMA

Çfarë është trauma psikologjike?

Përgjigje emocionale, psikologjike dhe neurobiologjike ndaj një ngjarjeje ose serie ngjarjesh që tejkalojnë aftësinë e fëmijës për t’u përballur me to.

> *Trauma nuk është vetë ngjarja — por mënyra se si fëmija e përjeton ngjarjen.*

NGJARJE POTENCIALISHT TRAUMATIKE

- Dhunë fizike ndaj fëmijës
- Keqtrajtim psikologjik
- Dëshmim i dhunës ndërmjet prindërve
- Abuzim seksual
- Kërcënime
- Neglizhencë

PJESA E DYTË · TRAUMA

Karakteristikat themelore të traumës

Rrezikim

Fëmija ndjen se:

- nuk është i sigurt
- nuk ka kontroll
- askush nuk mund ta mbrojë

Pafuqishmëri

Dominon ndjenja: „Nuk mund të bëj asgjë.“

Mbingarkesë

Emocionet janë më të forta se kapacitetet për përballje.

PJESA E DYTË · TRAUMA

Neurobiologjia e traumës

Si reagon truri ndaj rrezikut kur fëmija është i ekspozuar ndaj dhunës?

Amigdala

- Bëhet hiperaktive.
- Vazhdimisht kërkon kërcënim.

Hipokampusi

- Më vështirë i organizon dhe i ruan kujtimet.

Korteksi prefrontal

Aftësi e zvogëluar për:

- koncentrim,
- të mësuar,
- planifikim dhe
- kontroll të impulseve

PJESA E DYTË · TRAUMA

Përgjigjet ndaj traumës

Fight
LUFTË

- agresivitet
- konfliktualitet

Flight
IKJE

- shmangie
- mungesa nga shkolla

Freeze
NGRIRJE

- tërheqje
- mpirje emocionale

Fawn
NËNSHTRIM

- përshtatje e tepruar
- nënshtrim

Faint
KOLAPS

- Rënie ose fikje e trupit kur kërcënimi është tepër i madh

Llojet e traumës

1 Traumë akute

Një ngjarje:

- sulm fizik
- dëshmim i një incidenti serioz

2 Traumë kronike

Ngjarje të përsëritura:

- dhunë e vazhdueshme në familje
- neglizhencë.

3 Traumë komplekse

Ekspozim afatgjatë ndaj më shumë formave të dhunës.
Më e shpeshtë te fëmijët nga familje disfunksionale.

4 Traumë zhvillimore

E çrregullon zhvillimin e lidhjes, vetëbesimit, identitetit dhe rregullimit emocional.

PJESA E DYTË · TRAUMA

Reagime traumatike te fëmijët - simptomat

MOSHA PARASHKOLLORE

- Të qara, regresion
- Urinim në shtrat
- Frikë nga ndarja

SHKOLLA FILLORE

- Agresivitet
- Probleme me vëmendjen
- Mossukses shkollor
- Ankesa somatike

ADOLESHENCA

- Depresivitet
- Sjellje e rrezikshme
- Keqpërdorim i substancave
- Vetëlëndim
- Izolim

PJESA E DYTË · TRAUMA

Trauma dhe funksionimi shkollor

Si duket fëmija i traumatizuar në shkollë?

SHPESH INTERPRETOHET GABIMISHT SI

Dembel, i padëgjueshëm, manipulativ, i painteresuar

→

E NË TË VËRTETË MUND TË JETË

Hipervigjilent, i frikësuar, kronikisht i shqetësuar, i mbingarkuar

SHENJA TIPIKE

- Rënie e menjëhershme e suksesit
- Mungesa të shpeshta
- Konflikte me bashkëmoshatarët
- Izolim
- Të qara
- Irritim i tepërt
- Rënie e koncentrimit

PJESA E DYTË · TRAUMA

Qasje e informuar për traumën në shkollë

JO *„Çfarë nuk është në rregull me këtë fëmijë?“*

POR *„Çfarë i ka ndodhur këtij fëmije?“*

Parimet kyçe

Siguria

Fëmija duhet të ndjejë se është i mbrojtur.

Parashikueshmëria

Rregulla të qarta dhe kufij të qartë.

Lidhshmëria

Raporti me të rriturin është faktor mbrojtës.

Fuqizimi

Fëmija të fitojë ndjenjë kontrolli.

PJESA E DYTË · TRAUMA

Trauma dhe rezilienca

Rezilienca është aftësia për adaptim dhe rimëkëmbje pas përvojave të vështira.

Faktorë mbrojtës

Individualë

- Vetëbesim
- Shkathtësi emocionale

Familjarë

- Prind mbështetës

Shkollorë

- Mjedis i sigurt
- Mësimdhënës i besueshëm
- Psikolog shkollor

Bashkësia

- Shërbime të qasëshme
- Mbështetje sociale

STUDIM RASTI

Ana, 13 vjeçe

Në dy muajt e fundit:

- Suksesi ka rënë dukshëm
- Është tërhjekur
- Shpesh qanë
- Probleme me koncentrimin

> *„Nuk më zen gjumi kur babi i bërtet mamit“*

PYETJE PËR PUNË NË GRUP

1. Cilat reagime traumatike i vërejtët?
2. Cilët janë faktorët e rrezikut?
3. Cilët janë faktorët mbrojtës?
4. Si do të dukej plani intervenues?
5. Cilët institucione duhet të kyçen?

NPP

Ndihma e parë psikologjike

Sipas **World Health Organization** и **International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies**, NPP është

një përgjigje humane, mbështetëse dhe praktike ndaj një personi që ka përjetuar një ngjarje krize ose traumatike..

NPP NUK ËSHTË

- × **Psikoteripi**
- × **Këshillim i thellë**
- × **Intervistë fornzike**
- × **Hulumtim i rastit**

npp

Bazat e NPP

1 Shiko
LOOK

Vlerëso:

- A është fëmija i sigurt?
- A ka rrezik të drejtpërdrejt?
- A është e nevojshme ndihma mjekësore?
- A është i shqetësuar emocionalisht?

Pyetje

- „Si je sot?“
- „A ndjehesh sigurt në këtë moment?“

2 Ndëgjo
LISTEN

Ndëgjim aktiv:

- Ton i qetë
- Kontakt me sy
- Pa gjykime
- Pa ndërprerje

Fraza

✔️ „Të faliminderit që më tregove.“

✔️ „Të dëgjoj.“

✔️ „ E Kuptoj se kjo është shumë e vështirë për ty.“

3 Ndërlidh
LINK

Lidhja me:

- Prindin që nuk është i dhunshëm
- Qendra për punë sociale
- Institucion shëndetësor
- Mbështetje psikologjike
- Policia kur është e nevojshme

NPP

Kufijtë në NPP

Psikologu / punëtori profesional NUK GUXON

Të mos zhvillojë hetime
✘ "Më trego saktësisht çfarë ka ndodhur?"
✘ "Sa herë të ka goditur?"
✘ "Kush është fajtor?"

Të premtoj fshehtësi
✘ "Kjo do të mbetet mes nesh."
Në vend të kësaj:
"Do ta ruaj privatësinë tënde, por nëse dikush është në rrezik, do të më duhet të kërkoj ndihmë nga persona ose institucione që mund të të mbrojnë."

Të ndërmjetësojë mes dhunuesit dhe viktimës

Psikologu shkollor nuk zbaton mediacion familjar kur egziston dhunë.

Të kryek psikoterapi

NPP është ndërhyrje afatshkurte

GABIMI MË I SHPESHTË TE PSIKOLOGËT SHKOLLORË / BASHKËPUNËTORËT PROFESIONALË ËSHTË PËRPJEKJA PËR T'U BËRË HETUES, NDËRMJETËSUES OSE TERAPISTË.

ZBULIMI I DHUNËS · 1–2

Si të reagojë psikologu kur zbulon dhunë familjare

1 Qetësisht

Mos tregoni shok. shmangni reagime si:

× **„Çkaaaa?“**

× **„Nuk mund ta besoj!“**

2 Validim

✔ **„Më vjen mirë që ma the.“**

✔ **„Ishte guxim që fole për këtë.“**

Si të reagojë psikologu kur zbulon dhunë familjare

3 Vlerësim i sigurisë

Pyetje:

- A të ka lënduar dikushi?
- A frikësohesh që të shkosh në shtëpi?
- A është dikush tjetër në rrezik?

4 Hapat e rradhës

Sqarim i hapave të rradhës:

✔️ **„Puna ime është të të ndihmoj të jesh i sigurt.“**

✔️ **„Do flas me njerëz që mund të të ndihmojn.“**

INTERVISTË ME FEMIJUN

Intervistë me fëmijun-viktimë e dhunës familjare

DËGJIM AKTIV

“

Reflektim

Përsëritje e ndjesisë ose mesazhit: “Ndjehesh I dëshpëruar”

Përmbledhje

Përsëritje e pikave kryesore: “domethënë, problemi është presioni dhe mungesa e mbështetjes.”

Validim

Pranimi se ndjenjat janë të kuptueshme: “është normale të ndihesh ashtu.”

PRINCIPET E INTERVISTËS

- **Siguri**
- **Respekt**
- **Mosgjykim**
- **Mbrojtja e dinjitetit**

INTERVISTË ME FËMIJUN

Intervistë me fëmijun-viktimë e dhunës familjare

Çfarë pyetje të parashtrojmë?

Të hapura

„Më trego çka ndodhi.“

„Si u ndjeve atëherë?“

Të mbyllura

Vetëm kur është e domosdoshme.

Të ndaluara

- × „Babai të goditi, ashtu?“
- × „Sigurisht se u frikësove?“
- × „Pse nuk tregove më herët?“

Change the font face.

Formular për intervistë me fëmijë viktimë të dhunës (qasje e informuar për traumë)

Të dhëna bazë

Data/koha

Psikologu

Inicialet e fëmijës

1. Fillimi – krijimi i sigurisë

Shembull hyrjeje: *„Këtu je në një vend të sigurt. Nuk je i detyruar të thuash asgjë që nuk dëshiron. Unë do të dëgjoj dhe do të bëjmë një plan se si të jesh i/e sigurt."*

- ☐ Është shpjeguar roli dhe kufijtë e konfidencialitetit.
- ☐ Është konfirmuar se fëmija e kupton që nëse ka rrezik për sigurinë, psikologu duhet të kërkojë ndihmë.

2. Pyetje të hapura (pa sugjerime)

1. „Cfarë ndodhi?"
2. „Cfarë ndodhi më pas?"
3. „Ku ndodhi kjo?"
4. „Kush ishte i pranishëm?"
5. „Si u ndjeve?"
6. „A ndihesh i/e sigurt tani?"
7. „Cfarë të ndihmon kur je i/e frikësuar?"

Shmangni:

- „Babai yt të goditi, apo jo?"
- „Nëna jote ishte e dehur?"
- „Të rrahin çdo ditë?"
- „Pse nuk tregove më parë?"
- „Sigurisht që nuk ka qenë aq tmerrshme."

3. Informacionet minimale të nevojshme për sigurinë

Pyetje	Shënim
A ka rrezik aktual?	
A mund të përsëritet dhuna sot/sonte?	
_____	A ka ndonjë i rritur të sigurt tek i cili fëmija ka besim?
_____	A ka lëndime që kërkojnë vlerësim mjekësor?
_____	A ka fëmija mendime për të lënduar veten?
_____	

4. Deklaratat direkte të fëmijës (shënoni tekstualisht)

_____

_____

_____

_____

5. Vëzhgimet e psikologut (jo interpretime)

- Lëndime të dukshme/veshja: _____
- Afekti (të qara, anktu, tërheqje): _____
- Sjellja gjatë bisedës: _____
- Prania e shoqëruesit dhe dinamika: _____

6. Vlerësimi i urgjencës

Kriteri	Po	Jo
Rrezik i menjëhershëm për jetën/integritetin fizik	☐	☐
Lëndime serioze/nevojë mjekësore	☐	☐
Dhunë seksuale/shfrytëzim seksual	☐	☐
Frikë e theksuar nga kthimi në shtëpi	☐	☐
Synime/plan për vetëvrasje	☐	☐

Nëse ndonjë nga kriteret e mësipërme është „Po":

1. Mos e lini fëmijën vetëm.
2. Njoftoni drejtorin menjëherë.
3. Kontaktoni Qendrën për Punë Sociale (QPS) dhe/ose policinë sipas protokollit dhe rrezikut të menjëhershëm.
4. Organizoni një vlerësim mjekësor kur është e nevojshme.
5. Mos bëni pyetje shtesë „për të mësuar më shumë."

7.Plani për hapat e ardhshëm

Aktiviteti (masat)	Personi përgjegjës	Afati
Mbështetje psikologjike	_____	_____
Plan për siguri	_____	_____
Njoftim/referim	_____	_____
Takim(përsëri)	_____	_____

Nënshkrim:_____

Skenar i shkurtër për mbylljen e bisedës

„Falemindert që bisedove me mua. Kjo që ke thënë është e rëndësishme. Ne do të bëjmë një plan për sigurinë tënde dhe do të përfshijmë njerëz që mund të ndihmojnë. Nëse ndihesh në rrezik para takimit të radhës, eja menjëherë tek unë / mësuesi / drejtori."

USHTRIM

Rasti: Mentori, klasa e 6

Në periudhën e fundit, mësuesit vërejnë se ai është i heshtur, shmang kontaktin me bashkëmoshatarët dhe shpesh duket i lodhur. Disa herë nuk i ka detyrat e shtëpisë, ndërsa në orë mësimore ka vështirësi në koncentrim.

Një ditë, mësuesja vëren një mavijosje në parakrahun e tij. Kur e pyet çfarë ka ndodhur, Mentori përgjigjet shkurt: “Asgjë, u rrëzova.”

Në bisedë me shërbimin profesional, Mentori duket i shqetësuar, vazhdimisht shikon poshtë dhe thotë se nuk dëshiron “të krijojë probleme në shtëpi.”

.

Qëllimi i aktivitetit: Nxënësit të analizojnë qasjen (**trauma-informed**), ta njohin dhe të reagojnë në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale.

PYETJE PËR ANALIZË

1. Cilët indikatorë për keqpërdorim të mundshëm janë prezent?
2. Çfarë reagime emocionale tregon fëmiju ?
3. Cilat pyetje do të ishin më të përshtatshme gjatë bisedës?
4. Çka duhet të shmangim gjatë intervistës?
5. Cilat janë hapat e rradhës të shërbimit profesional?

PROTOKOLET DHE PRAKTIKAT

Shkollë e informuar mbi traumën

Shkollë që kupton se si ndikon trauma në:

Mësim | Sjellje | Raporte

FORMULARËT

1. Identifikimi i hershëm
2. Raportim / referim
3. Ndjekja — 3 / 6 / 9 muaj

Qëllimi: Shkolla të bëhet një mjedis që e njeh dhe i përgjigjet traumës.

SHKOLLE E INFORMUAR MBI TRAUMËN

Puna me mësimdhënës dhe prindër

Me mësimdhënësit

Trajnim i mësimdhënësve të identifikojnë:

- Hipervigjilencën
- Tërheqjen
- Disocimin
- Agresivitetin

Me prindërit

- Psikoedukim
- Përforcim i kapaciteteve prindërore
- Bashkëpunim me institucionet

KUJDESI PËR PSIKOLOGUN

Parandalimi i traumatizimit sekondar dhe sindromës së djegies profesionale te psikologët shkollorë

TRAUMATIZIMI SEKONDAR- Ndikimi emocional nga dëgjimi i rrëfimeve traumatike

Simptomat e traumatizimit sekondar

EMOCIONAL

- Pikëllim
- Zemërim
- Ankth

KOGNITIV

- Mendime obsesive
- Probleme me koncentrimin

FIZIKE

- Lodhje
- Pagjumësi

KUJDESI PËR PSIKOLOGUN

Djegia profesionale

SIMPTOMET

- Shterim emocional
- Cinizëm
- Ndjenjë e ulët e kompetencës
- Nivel i ulët i tolerancës ndaj frustrimit
- Rënie e aftësive kognitive
- Rënie e fuqisë dhe energjisë fizike
- Nivel i rritur i shqetësimit dhe iritimit
- Çrregullim i gjumit

FAKTORËT E RREZIKUT

- Numër i madh i rasteve
- Mungesë e mbështetjes
- Izolim profesional
- Histori personale e traumës

FAKTORËT MBROJTËS

✔️Supervizim

✔️Mbëeshtjetje profesionale (Oda e Psikologëve – Seksioni i psikologëve shkollorë)

✔️Kujdesi për veten

✔️Balansimi i punës-jetës private

03

PJESA E TRETË

Veprimi institucional dhe dokumentimi



VEPRIMI INSTITUCIONAL

Bashkëpunim me institucionet

Psikologu i shkollës nuk punon vetë.

Institucionet kyçe

Qendra për punë sociale

Policia

Institucionet shëndetësore

VEPRIMI INSTITUCIONAL

Veprimi institucional dhe dokumentimi

Hapat kryesorë para veprimit

1. Sigurimi i sigurisë së fëmijës
2. Komunikim i qetë dhe mbështetës
3. Vlerësimi i rrezikut dhe urgjencës
4. Njoftim në kohë i institucioneve kompetente
5. Respektim I besueshm;risë dhe parimeve etike

VEPRIMI INSTITUCIONAL

Veprimi institucional dhe dokumentimi

Dokumentimi

1. Regjistrimi objektiv i informatave
2. Data, ora dhe përshkrimi i ngjarjes
3. Deklarata të shënuara pa interpretim
4. Evidentimi i hapave të ndërmarrë
5. Ruajtja e dokumenacionit sipas protokoleve

VEPRIMI INSTITUCIONAL

Veprimi institucional dhe dokumentimi

Bashkëpunimi institucional

Ekipi profesional i shkollës → Qendra për punë sociale → Policia / shërbimet shëndetësore

Koordinimi dhe ndjekja e rastit.

ME RËNDËSI

Çdo dyshim për dhunë kërkon veprim profesional dhe në kohë të duhur.

INSTRUMENT

Formular për raportim institucional

Formular i standardizuar për raportimin e rastit te institucionet kompetente.

docs.google.com → Formular për raportim



FORMULAR PËR RAPORTIM INSTITUCIONAL

I dedikuar për (institucioni) _____

TË DHËNAT BAZIKE

Shkolla: _____

Bashkëpunëtori profesional: _____

Data: _____

TË DHËNA PËR NXËNËSIN

Emri dhe mbiemri: _____

Mosha/klasa: _____

PËRSHKRIMI I SHQETËSIMIT (fakte, pa interpretime)

_____

_____

_____

_____

REZULTATI NGA VLERËSIMI I RREZIKUT

Pikët totale: _____

Niveli i rrezikut: _____

VEPRIMET E NDËRMARRA (shëno me ✔)

- ☐ bisedë me nxënësin
- ☐ bisedë me prindin
- ☐ konsultim me mësimdhënësin
- ☐ ekipi i brendshëm

ARSYEJA E NJOFTIMIT

- ☐ dyshim për dhunë
- ☐ neglizhencë
- ☐ traumë psikologjike
- ☐ tjetër:_____

NDËRHYRJA E KËRKUAR

- ☐ vlerësim nga shërbimi social
- ☐ vizitë në terren
- ☐ mbështetje shtesë

NËNSHKRIM _____

STUDIM RASTI KOMPLEKS

Nxënës, 11 vjeç

Dëshmitar i dhunës kronike në familje.

- Tregon agresivitet
- Ka ulje të suksesit
- Refuzon të bisedojë

PJESËMARRËSIT DUHET TË

1. Bëjnë vlerësim të rrezikut
2. Realizojnë intervistë
3. Krijojnë plan të krizës
4. Aplikojnë qasje trauma-informuese
5. Identifikojnë rreziqet për traumatizim sekondar tek psikologu

PË FUND

Rekomandime kyçe

Detyra juaj është të ndihmoni, e jo të hulumtoni.

- **Siguria është gjithmonë prioritet**
- **Mos premtoni konfidencialitet të plotë**
- **Dokumentoni objektivisht**
- **Punoni në mënyrë multisektoriale**
- **Ndihma e parë psikologjike është mbështetje, stabilizim dhe lidhje me burime, jo terapi.**

Mendimi juaj ka rëndësi



Република Северна Македонија
Министерство за образование и наука

КОМОРА НА ПСИХОЛОЗИ
на Република Македонија

Ju faleminderit për vëmendjen!

- Mësojmë
- Parandalojmë
- Ndryshojmë